



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 9 Qershor 2021

Nr. 400

**VENDIM**

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të kërkesës nr. 1318 prot., datë 12.04.2021 të Institucionit të Presidentit të Republikës dhe kërkesës nr. 1414 prot., datë 20.04.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë ndaj Partisë Socialiste
- Kërkues:** Presidenti i Republikës së Shqipërisë, SH.T.Z Ilir Meta
- Ndaj:** Kryetarit të Partisë Socialiste, AKSHI, drejtues të tjerë të Partisë Socialiste
- Baza Ligjore:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 23 i ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata e KQZ-së gjatë shqyrtimit administrativ,

**VËREN:**

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 1318 prot., datë 12.04.2021, është deponuar nga Institucioni i Presidentit të Republikës, kërkesa me lëndë: “Kërkohet nisja e hetimeve mbi keqpërdorimin e të dhënave personale të qytetarëve Shqiptarë dhe të bazës së të dhënave shtetërore nga Partia Socialiste”. Në vijimësi të kësaj shkrese, Presidenti i Republikës së Shqipërisë



ka depozituar shkresën nr. 1414 prot., datë 20.04.2021, me të njëjtën lëndë: “Kërkesë e përsëritur për kryerjen e hetimeve proaktive mbi keqpërdorimin e të dhënave personale të qytetarëve Shqiptarë dhe të bazës së të dhënave shtetërore nga Partia Socialiste”.

Referuar kërkesave me të njëjtin objekt, pretendohet se: “*Strukturat politike të Partisë Socialiste mbajnë, administrojnë dhe përpunojnë një bazë të dhënash në format elektronik me tregues sensitive individuale dhe konfidenciale të shtetasve me të drejtë vote në Republikën e Shqipërisë. Sipas asaj që është bërë publike, rezulton se ky model formati, që administrohet dhe përpunohet nga Partia Socialiste, ka të dhëna të njëjta me ato që administrohen nga AKSHI, përmes portalit e-albania.*

*Çdo përdorim i këtyre të dhënave, qoftë për të furnizuar baza të tjera të dhënash që krijohen nga një parti politike për qëllime të saj, është një cenim skandaloz i të dhënave personale të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, që veç të tjerave krijon terren për keqpërdorim të tyre”.*

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “*Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi*”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht faktin nëse është apo jo organi publik kompetent, për shqyrtimin e tyre.

Juridiksioni dhe kompetenca janë parakushte procedurale që duhet të plotësohen në mënyrë që të krijohet një marrëdhënie juridike procedurale e vlefshme.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Lidhur me këto kërkesa të depozituara nga Institucioni i Presidentit të Republikës dhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë, të cilat kanë si objekt: “Keqpërdorim të të dhënave personale”, “Shpërdorimin e



detyrës” dhe “Përdorimin e funksionit publik për veprimtari politike dhe zgjedhore”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nuk mund të jenë objekt shqyrtimi nga ana e tij, pikërisht për shkak të mungesës së kompetencës së këtij organi për shqyrtimin e tyre.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se kërkesat janë jashtë kompetencës së tij lëndore dhe nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ, për këto kërkesa të depozituara nga Institucioni i Presidentit të Republikës dhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 23 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”:

### **V E N D O S:**

1. Të shpallë moskompetencën lëndore të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shqyrtimin e kërkesave.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

